# AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "S & T Albania"

Keshilli drejtues i shoqerise S&T System Integration & Distribution AG Vienna ne mbledhjen e tij te dates 16.09.2004 vendosi te

themeloje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin social "S & T Albania" SHPK, me seli ne Tirane, ne adrese Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit" P.7, P.O.Box 1404.

2) Objekti i shoqerise eshte:

- Botime te ndryshme
- Riprodhimi i rregjistrimeve kompjuterike, prodhimi i CD, i produkteve plastike, i kompjuterave dhe paisjeve te tjera te perpunimit te te dhenave, i kabllove elektronike, i valvolave elekronike dhe pjeseve te tjera elektronike, i instrumentave dhe paisjeve te matjes, kontrollit, testimit dhe navigimit, i paisjeve per kontrollin e perpunimit industrial.
- Punime ndertimi, instalime elektrike, punime instalimi te kerkuara ne ndertim
- Agjensi per shitjen e makinerive, paisjeve industriale, anijeve, avioneve dhe produkteve te tjera
- Tregeti me shumice te makinave perpunuese, te paisjeve kompjuterike, te makinerive dhe paisjeve te zyrave, te pjeseve elektronike dhe paisjeve, te makinave te tjera te perdorura ne industri, tregti dhe lundrim.
- Tregeti me pakice te librave, te paisjeve elektroshtepiake, pjeseve te radiove dhe televizoreve
- Telekomunikacion
- Qira financiare, qira paisjesh zyre dhe kompjuteri, qira makinerish dhe paisjesh te tjera
- Konsulence per paisjet kompjuterike
- Prodhimi i paketave te programeve, furnizimi me software dhe sherbime konsulence, perpunim te dhenash, aktivitete lidhur me data base
- Mirembajtje dhe riparim paisjesh zyre dhe kompjuterike si dhe aktivitete te tjera lidhur me kompjuterat
- Kerkime dhe eksperimentime ne fushen e shkencave natyrale, ne teknologji, ne fushen e shkencave humane
- Kontabilitet, finance dhe auditim, konsulence taksash, kerkime mbi tregun, konsulence ndermarjesh dhe biznesi.
- Monitorim gjeodet, gjeologjik, gjeofizik, gjeokimik, matje, shpim.
- Studime urbanistike
- Projektim arkitekturor dhe ndertimor, konsulence teknike lidhur me to.
- Testim teknik dhe analize, reklame, calling center, organizim ekspozitash, panairesh dhe kongresesh.

3) Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i papercaktuar dhe shoqeria mund te shperbehet ne cdo kohe qe nga dita e rregjistrimit te saj zyrtar, me vendimin e ortakut te vetem, sipas modaliteteve ligjore.

4) Kapitali shoqeror eshte leke 100.000 (njeqindmije) dhe i nenshkruar ne masen 100% nga ortaku i vetem S&T System Integration & Distribution AG Vienna.

Kapitali mund te rritet ne te ardhmen sipas modaliteteve ligjore.
Kapitali shoqeror eshte i perbere nga 100 kuota krejtesisht te paguara, me vlere prej 1.000 leke secila, me numra serie nga 1 deri 100.

5) Shoqeria do te administrohet nga administratori Kladvij Godnič.
Administratori perfaqeson shoqerine perballe te treteve dhe ngarkohet me procedurat e administrimit te zakonshem te shoqerise.

6) Vitet ushtrimore mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti. Viti i pare ushtrimor mbyllet me 31 dhjetor 2005.

Ky akt themelimi eshte hartuar ne Tirane ne pese ekzemplare.

Shoqeria krijohet dhe do te ushtroje aktivitet ne perputhje me ligjet shqiptare ne fuqi, L.n. 7638 del 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare" dhe ligje te tjera qe do te jene ne fuqi gjate periudhes se aktivitetit te shoqerise, si dhe ne perputhje me statutin qe konsiderohet pjese perberese e ketij akti dhe qe i bashkengjitet si ANEKSI B.

Lexuar, pranuar dhe nenshkruar;

**ORTAKU THEMELUES:**

KLAVDIJ GODNIC

**S & T System Integration & Distribution AG Vienna**
**KLAVDIJ GODNIČ**

ANEKS B

# STATUT

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## "S&T Albania" SHPK

## (ne zbatim te ligjit n. 7638 date 29.11.1992 )

### KREU I
### Emertimi - objekti,
### Selia – Afati

**Art.1**

Eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin social "S&T Albania". Emertimi i shoqerise do te shfaqet ne te gjitha aktet qe do te dalin ne emer dhe per llogari te shoqerise. Ne kete statut shoqerise se lartpermendur do t'i referohemi si "Shoqeria".

**Art.2**

Shoqeria ka si objekt te aktivitetit te saj:

- Botime te ndryshme
- Riprodhimi i rregjistrimeve kompjuterike, prodhimi i CD, i produkteve plastike, i kompjuterave dhe paisjeve te tjera te perpunimit te te dhenave, i kabllove elektronike, i valvolave elekronike dhe pjeseve te tjera elektronike, i instrumentave dhe paisjeve te matjes, kontrollit, testimit dhe navigimit, i paisjeve per kontrollin e perpunimit industrial.
- Punime ndertimi, instalime elektrike, punime instalimi te kerkuara ne ndertim
- Agjensi per shitjen e makinerive, paisjeve industriale, anijeve, avioneve dhe produkteve te tjera

- Tregeti me shumice te makinave perpunuese, te paisjeve kompjuterike, te makinerive dhe paisjeve te zyrave, te pjeseve elektronike dhe paisjeve, te makinave te tjera te perdorura ne industri, tregti dhe lundrim.
- Tregeti me pakice te librave, te paisjeve elektroshtepiake, pjeseve te radiove dhe televizoreve
- Telekomunikacion
- Qira financiare, qira paisjesh zyre dhe kompjuteri, qira makinerish dhe paisjesh te tjera
- Konsulence per paisjet kompjuterike
- Prodhimi i paketave te programeve, furnizimi me software dhe sherbime konsulence, perpunim te dhenash, aktivitete lidhur me data base
- Mirembajtje dhe riparim paisjesh zyre dhe kompjuterike si dhe aktivitete te tjera lidhur me kompjuterat
- Kerkime dhe eksperimentime ne fushen e shkencave natyrale, ne teknologji, ne fushen e shkencave humane
- Kontabilitet, finance dhe auditim, konsulence taksash, kerkime mbi tregun, konsulence ndermarjesh dhe biznesi.
- Monitorim gjeodet, gjeologjik, gjeofizik, gjeokimik, matje, shpim.
- Studime urbanistike
- Projektim arkitekturor dhe ndertimor, konsulence teknike lidhur me to.
- Testim teknik dhe analize, reklame, calling center, organizim ekspozitash, panairesh dhe kongresesh.

**Art.3**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit" P.7, P.O.Box 1404, Tirane.
Ortaku i vetem ka te drejte te hape seli sekondare, filiale, zyra perfaqesimi dhe agjensi si ne Shqiperi ashtu dhe jashte saj, madje dhe te transferoje seline e shoqerise, por kjo e fundit gjithesesi do te mbetet ne territorin e Republikes se Shqiperise.

**Art.4**

Vendqendrimi zyrtar i ortakut per cdo raport me shoqerine eshte adresa qe rezulton nga libri i ortakeve.

**Art.5**

Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i papercaktuar dhe shoqeria mund te shperbehet ne cdo kohe qe nga dita e rregjistrimit te saj zyrtar, me vendimin e ortakut te vetem, sipas modaliteteve ligjore.

**Kreu II**
**Kapitali shoqeror dhe kuotat**

**Art. 6**

Kapitali shoqeror eshte fiksuar ne Leke 100.000 (njeqindmije) dhe mund te rritet sipas modaliteteve ligjore. Kapitali eshte nenshkruar ne masen 100% nga ortaku i vetem i shoqerise : S & T System Integration Technology Distribution AG.

**Art. 7**

Kapitali shoqeror eshte i ndare ne 100 kuota, me vlere leke 1.000 secila.

**Kreu III**
**Administrimi**

**Art.8**

Shoqeria administrohet nga nje administrator, i cili qendrojne ne detyre deri ne revokimin e tij nga asambleja ose kur jep doreheqjen dhe eshte i rizgjedhshem.

Me kete akt, administrator i shoqerise emerohet Z.Klavdij GODNIC, per nje mandat 4-vjecar nga data e rregjistrimit te shoqerise.

**Art.9**

Administratori ka te drejta te cdo lloji, kufizuara dhe te lidhura me drejtimin e zakonshem te shoqerise, dhe qe synojne permbushjen dhe realizimin e objektit shoqeror te shoqerise, te drejta keto qe nga ligji nuk jane njohur taksativisht per ortakun e vetem.

**Art.10**

Administratori, ne menyre individuale, ka te drejten e firmes perfaqesuese te shoqerise perballe te treteve dhe ne gjykim, me te drejten qe te kryejne veprime, procedura ne shkalle te ndryshme gjyqesore dhe administrative.

**Art.11**

Administratori mund te emeroje drejtore dhe perfaqesues dhe midis personave jashte shoqerise duke vendosur shperblimet perkatese.

**Art.12**

Administratori mund te delegoje pjese te te drejtave dhe kompetencave te tyre, perfshire dhe te drejten e perdorimit te firmes se shoqerise nje ose disa perfaqesuesve te vecante, duke i caktuar ketyre kompetencat, funksionet dhe shperblimet.

**Art.13**

Administratori qe nuk ka marre pelqimin paraprak te ortakut te vetem, nuk mund te jete ortak ne shoqeri konkurente dhe nuk mund te ushtroje per llogari te vet aktivitete konkuruese me objektin shoqeror te shoqerise.

## Kreu IV
## Bilanci dhe te ardhurat

**Art.14**

Vitet ushtrimore mbyllen me 31 dhjetor te cdo viti dhe viti i pare mbyllet me 31 dhjetor 2005.

Ortaku i vetem e aprovon bilancin brenda kater muajve nga mbyllja e vitit ushtrimor.

**Art. 15**

Te ardhurat neto, pasi eshte zbritur shuma prej 5% e destinuar per fondin e zakonshem rezerve, derisa kjo kuote te mos kete arritur 1/5 e kapitalit te shoqerise, do te perfitohen nga ortaku i vetem.

## Kreu V
## Shperberja dhe likuidimi

**Art.16**

Duke pasur te drejte te vendose, ne cdo kohe dhe per cdo shkak shperberjen e shoqerise, ortaku i vetem percakton modalitetet e likuidimit dhe emeron nje ose disa likuidatore, duke marre ne konsiderate normat detyruese te ligjit.

## Kreu VI
## Kompetenca gjyqesore

**Art.17**

Organi gjyqesor kompetent per shoqerine eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

**Kreu VII**
**Dispozita te pergjithshme**

**Art.18**

Cfare nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut, rregullohet ne baze te dispozitave te ligjit shqiptar ne fushen e shoqerive me pergjegjesi te kufizuar.

**Art.19**

Ky statut eshte hartuar ne Tirane ne pese ekzemplare, me te njejten vlefshmeri.

Ortaku themelues deklaron te kete rilexuar kete akt qe e pranon teresisht me nenshkrimet e tij:

**ORTAKU THEMELUES:**

KLAVDIJ GODNIC

**S & T System Integration & Distribution AG Vienna**
**KLAVDIJ GODNIČ**